



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 46/2022 regjistër (JR)
Datë 19.10.2022

Nr. 36 i vendimit
Datë 07.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 07.05.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me sekretar gjyqësor Kevin Kovaçica, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 46/2022 (JR), datë 19.10.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Alfred Sali, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 555, datë 22.07.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Alfred Sali (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas së cilave:

2.1 ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit, dërgoi aktin e përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit Alfred Sali¹, me konstatimet se: (a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (b) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë*; (c) *ka kryer fshehje të pasurisë*; (d) *ka kryer deklaram të rremë*; (e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*;

2.2 DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës, dërgoi raportin² mbi kontrollin e figurës së subjektit në të cilin konstaton *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Alfred Sali*;

2.3 KLP-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, ka përgatitur një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Komisioni, pasi kreu një hetim administrativ mbi të tria kriteret e rivlerësimit, me vendimin nr. 555, datë 22.07.2022, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Alfred Sali, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë*. Ky vendim u mor bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në pikat 1, 2, 3 dhe 5, në nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës, në pikës 1/c të nenit 58 dhe të pikave 3 dhe 5, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi, për secilin kriter rivlerësimi, Komisioni arriti në konkluzionet si më poshtë.

a. *Në lidhje me kriterin e pasurisë ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë. Nga analiza financiare rezulton se me të ardhurat e fituara nga punësimi i tij dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur burime të mjaftueshëm financiare për kryerjen e*

¹ Shkresë nr. {***} prot., date 30.01.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Alfred Sali, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

² Shkresë nr. {***} prot., datë 02.11.2017, “Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Sali”, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. {***}, datë 21.01.2022, të KDZh-së.

³ Raporti nr. {***} prot., datë 15.02.2022, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Alfred Sali”.

investimeve dhe të shpenzimeve të deklaruar, duke rezultuar me një balancë financiare negative në shumën 8.707.775 lekë. Për sa më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit Alfred Sali nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

b. Lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës;

c. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është i aftë, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

d. Në vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

II. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

4. Kundër vendimit të Komisionit, ka ushtruar ankim⁴ subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” dhe 59/1 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 555, datë 22.07.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Alfred Sali*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte shkresore bashkëlidhur ankimit.
5. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka ngritur shkaqe ankimi që lidhen me themelin e çështjes, të cilat konsistojnë në interpretimin e gabuar të ligjit dhe të provave të administruara nga ana e Komisionit.
6. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

6.1 Në lidhje me “*Të drejtë përdorimi (qiramarrës) mbi një apartament me sipërfaqe 110,8 m², Vlorë*”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *konkluzioni i Komisionit është i gabuar*, mbështetur në argumentet si vijojnë: (i) megjithëse marrëdhënia e qirasë është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën e interesave private periodike (në vijim “DIPP”) e vitit 2016, ai ka deklaruar që në DIPP-në e vitit 2014 e në vijim adresë banimi lagjja “{***}”, Vlorë; (ii) mosdeklarimi i të drejtës së përdorimit të kësaj pasurie deri në vitin 2016, lidhet me neglizhencën e tij në përpilimin e deklaratave periodike; (iii) dokumentacioni shkresor i administruar gjatë hetimit administrativ prej shoqërisë “{***}” ShPK, vërteton banimin e tij në mënyrë të pandërprerë në këtë apartament prej vitit 2014 e aktualisht, kundrejt pagimit të çmimit të qirasë mujore në vlerën 20.000 lekë; (iv) nuk ka asnjë situatë konflikti interesi mes tij dhe administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK e as ndonjë marrëdhënie gjinie, krushqie etj.;

6.2 Në lidhje me “*Hua në vlerën 58.000 euro dhënë babait L. S. dhe gjendje cash në shumën 9.000 euro*”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *konkluzioni i Komisionit është jo i drejtë dhe i bazuar*, mbështetur në argumentat si vijojnë: (i) në të kundërt të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni ka pranuar në vendim përfitimin e shumës prej 75.860 eurosh përmes transfertës së bërë nga llogaria e tij pranë kompanisë “{***}”, në llogarinë e tij bankare pranë

⁴ Ankimi është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 11.10.2022.

Raiffeisen Bank ShA; (ii) nuk ka pasur ndonjë parashikim ligjor mbi mënyrën e disponimit të shumës 75.860 euro pas tërheqjes së saj nga Raiffeisen Bank ShA e as detyrim ligjor për vlerën *cash*, që duhet të mbahet jashtë sistemit bankar në këndvështrim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”); (iii) mospasqyrimi i shumës së tërhequr nga banka si gjendje *cash*, lidhet me moskuptimin e drejtë ose të kuptimit të gabuar të parashikimit ligjor mbi deklarin dhe pakësimin ose shtimin të gjendjes *cash*; (iv) nga ana e tij dhe e bashkëshortes është vlerësuar që shuma e disponuar prej tyre *cash*, e fituar në lojë fati, të ruhej e paprekur me qëllim kryerjen e ndonjë investimi të mëvonshëm, ndërkohë që kreditë e marra në kohë kanë qenë kredi konsumatore dhe janë përdorur për shpenzime familjare në vijimësi; (v) shuma e përfituar nga lojërat e fatit nuk është shpenzuar prej tij, pasi nga hetimi nuk rezultoi asnjë veprim juridik në drejtim të blerjes/investimit të ndonjë pasurie të paluajtshme, asnjë transfertë bankare apo investim në atë vlerë apo vlerë të përafërt; (vi) mosdeklarin i shumës së dhënë hua babait të tij, në DIPP-në e vitit 2016 ka qenë një harresë nga ana e tij; (vii) Komisioni, në analizën e tij, mbi ecurinë e likuiditeteve *cash* ndër vite, shtesave/pakësimeve, ka përlogaritur shumat e deklaruara prej tij në deklaratat periodike, duke deduktuar se gjendja e *cash*-it në monedhën lekë në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 1.050.000 lekë dhe ka si burim pagat, ndërkohë që nga ana e tij nuk është kryer deklarin për gjendjen *cash* dhe rrjedhimisht as pakësimin e saj ndër vite ose burimin e tyre;

6.3 Në lidhje me “*Analizën financiare për periudhën 2003 – 2016*”, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni edhe pse ka konkluduar se është provuar fitimi i shumës prej 75.860 eurosh nga lojëra fati dhe se transfertat e saj nuk është e dyshimtë, në mënyrë paradoksale nuk e merr në konsideratë këtë të ardhur në analizën financiare.

7. Shkaqet e ankimit, për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe cenimin e besimit të publikut, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1 Konkluzionet e Komisionit, në lidhje me procedimet penale nr. {***/2018 dhe nr. {***/2020, janë të gabuara dhe të pabazuara;

7.2 Konkluzioni i Komisionit lidhur me cenimin e besimit të publikut është i gabuar, pasi besimi i publikut nuk mund të jetë një koncept abstrakt dhe se Komisioni ka dështuar të arsyetojë se cilat janë kriteret e përdorura e të matshme për të pasur cenim besimi të publikut.

III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Alfred Sali, bën pjesë në

juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 555, datë 22.07.2022, të Komisionit, për shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit Alfred Sali, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
10. Trupi gjykues, fillimisht, referuar përmbajtjes së ankimit, konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka adresuar shkaqe ankimi apo pretendime për shkelje të rënda procedurale të Komisionit, që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pavarësisht këtij konstatimi, trupi gjykues i Kolegjit kontrolloi procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni në drejtim të respektimit të primeve të procesit të rregullt ligjor, në përfundim të të cilit nuk u konstatuan shkelje procedurale të asaj natyre për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve, sipas kushteve të parashikuara nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Për këtë arsye, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

E drejtë përdorimi (qiramarrës) mbi një apartament me sipërfaqe 110,8 m², në Vlorë

11. Komisioni ka arritur në konkluzionin se *marrëdhënia e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK, për periudhën 2014 - 01.01.2017, nuk është një marrëdhënie qiraje, por është një marrëdhënie huapërdorje pakundërshtëpërblim. Veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit, me plotësimin e deklaratës vetting e në vijimësi, duken të tilla për të fshehur këtë marrëdhënie huapërdorje midis subjektit dhe shoqërisë tregtare “{***}” ShPK.*
12. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni ka gabuar në konkluzionin e tij, pasi marrëdhënia në fjalë është një marrëdhënie qiraje, ashtu sikurse është deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë vetting, mbështetur në argumentet si vijojnë: (i) megjithëse marrëdhënia e qirasë është deklaruar për herë të parë në deklaratën e pasurisë vetting dhe në DIPP-në e vitit 2016, ai ka deklaruar që në DIPP-në e vitit 2014 e në vijim adresë banimi lagjja “{***}”, Vlorë, por pa deklaruar marrëveshje/kontratë qiraje për këtë pasuri; (ii) mosdeklarimi i të drejtës së përdorimit të kësaj pasurie në deklaratat periodike vjetore deri në vitin 2016, sikurse me të drejtë konstatuar nga Komisioni, lidhet me neglizhencën e tij në përpilimin e deklaratave*

periodike; (iii) dokumentacioni shkresor i administruar gjatë hetimit administrativ⁵, prej pronarit të sendit shoqërisë “{***}” ShPK, vërteton banimin e tij në mënyrë të pandërprerë në këtë apartament prej vitit 2014 e aktualisht, kundrejt pagimit të çmimit të qirasë mujore në vlerën 20.000 lekë, pra, kundrejt shpërblimit, dhe se pagesat janë kryer *cash*, pasi nuk ekzistonte parashikim ligjor që ato të kryheshin në rrugë bankare; (iv) nuk ka asnjë situatë konflikti interesi mes tij dhe administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK e as ndonjë marrëdhënie gjinie, krushqie etj., që kjo pasuri t’i lihej në përdorim pakundërshpërblim.

13. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe kontrolloi arsyetimin e Komisionit në vendim, konstatoi dhe vlerësoi si vijon.

13.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, në disa rubrika të saj, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) në rubrikën e adresës së vendqëndrimit tjetër, deklarohet: *Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Kulla {***}, kati {***}, Vlorë*; (ii) në rubrikën “Deklarimi i pasurive”, deklarohet: *Të drejtë përdorimi (qiramarrës) mbi një apartament me sip. 110,8 m² pasuri nr. {***}, në z. k. {***}, ZVRPP-ja Vlorë. Kontratë qiraje verbale (20.000 lekë në muaj) lagjja “{***}”, Vlorë*; (iii) në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” deklarohet: *E drejta e përdorimit mbi një apartament me nr. {***} pasurie, lagjja “{***}”, Vlorë, në pronësi të personit juridik “{***}” ShPK, nr. {***}, me administrator E. F. Qira 20.000 lekë në muaj. Kontratë verbale prej vitit 2014 e në vijim*. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, ndër të tjera, dokumentet: (i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, lëshuar më datë 06.04.2011 dhe kartelë pasurie, sipas së cilave pasuria e llojit *apartament me sipërfaqe 110,8 m², nr. pasurie {***}, z. k. {***}, lagjja “{***}”, Vlorë, sh. {***}, k. {***}, ap. {***}*, figuron e regjistruar në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK; (ii) ekstrakt i shoqërisë “{***}” ShPK, me administratorët E. F. në periudhën 16.05.2014-16.05.2019 dhe D. F. në periudhën 15.08.2016-15.08.2021.

13.2 Nga verifikimi i deklaratave të interesave private periodike, të dorëzuara ndër vite pranë ILDKPKI-së, rezulton se:

i) në DIPP-të e viteve 2011-2012⁶, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë të regjistrimit të gjendjes civile, respektivisht: *Pallati nr. {***}, kati {***}, lagjja Nr.{***}, Sarandë dhe lagjja nr. {***}, rruga “{***}”, pallati nr. {***}, kati II, Sarandë*, ndërsa në rubrikën “*Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni*” ka deklaruar: *Lagjja “{***}”, Vlorë*. Në rubrikën “*Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit*” të këtyre deklaratave nuk janë deklaruar pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to;

ii) në DIPP-të e viteve 2013-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë të regjistrimit të gjendjes civile, të njëjtën adresë të lartcitur, ndërsa si adresë vendqëndrimi tjetër ka deklaruar: *Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Vlorë*. Në rubrikën “*Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit*” të këtyre deklaratave nuk janë deklaruar pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to;

iii) Në DIPP-në e vitit 2016 (dorëzuar pas deklaratës së pasurisë *vetting*), në rubrikën “*Nëse dispononi vendqëndrim tjetër, adresa e plotë ku banoni*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

⁵ Vërtetimet e shoqërisë “{***}” ShPK të datave 29.01.2020 dhe 02.07.2021.

⁶ Këto deklarata janë plotësuar nga subjekti në funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë, detyrë në të cilën është transferuar dhe e ka ushtruar që nga muaji dhjetor i vitit 2011 e në vijim.

Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Vlorë, ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, deklarohet: *Të drejta reale (qiramarrës) mbi një apartament, Kulla {***} nr. {***}, lagjja “{***}”, Vlorë dhe Person juridik “{***}” ShPK, nr. NIPTI {***}, me administrator E. F. Qiradhënës.*

13.3 Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së⁷ në datat 11.01.2016 dhe 20.01.2016, në përgjigje të pyetjes se kujt i përket adresa lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Vlorë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Adresa në Vlorë i përket apartamentit ku ne banojmë aktualisht me qira pranë Kulla “{***}” kati {***}. Shpenzimet e qerasë janë 20.000 lekë në muaj prej 2 vitesh. Nuk disponoj kontratë qiraje për këtë apartament, pasi me pronarin e apartamentit kemi lidhur një kontratë verbale dhe pagesat e qerasë, gjithashtu, janë kryer cash. I pyetur mbi mosdeklarimin e shpenzimeve të qirasë ndër vite, subjekti ka sqaruar se në kushtet që formulari i deklarimit të interesave private kërkonte vetëm deklarimin e shpenzimeve mbi 500.000 lekë e ka menduar të panevojshëm deklarimin e tyre. Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetim të shoqërisë “{***}” ShPK të datës 19.01.2016, nënshkruar nga administratori E. F., në të cilin vërtetohet se: *Alfred Sali banon me qira me një kontratë verbale në apartamentin nr. {***}, kati i {***}-të i kullës “{***}”, me adresë lagjja “{***}”, Bulevardi “{***}”, Vlorë, të ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, si dhe certifikatën e pronësisë dhe kartelën e pasurisë së apartamentit me sipërfaqe 110,8 m², nr. pasurie {***}, z. k. {***}, lagjja “{***}”, Vlorë, sh. {***}, k. {***}, ap. {***}, në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, të paraqitura edhe bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting.**

13.4 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit standard, në lidhje me adresat e banimit që nga momenti i marrjes së detyrës, si dhe faktin nëse është paguar ose jo qira, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: -- *janar 2012-dhjetor 2013 apartament me qira kulla “{***}”, kati {***}, lagjja “{***}”, Vlorë, qiradhënës shtetasi H. (mbiemri nuk më kujtohet). E drejtë përdorimi, marrëveshje verbale, vlera 20.000 lekë; -- janar 2014 e aktualisht, banesë me qira kulla “{***}”, lagjja “{***}”, hyrje {***}, marrëveshje verbale, 20.000 lekë. E drejta e përdorimit mbi një apartament me nr. {***} pasurie, lagjja “{***}”, Vlorë, në pronësi të personit juridik “{***}” ShPK, nr. NIPTI {***}, me administrator E. F./D. F.. Qira 20.000 lekë në muaj. Marrëveshje verbale. Në mbështetje të këtij të fundit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetim të shoqërisë “{***}” ShPK të datës 29.01.2020, nënshkruar nga administratorja D. F., i cili vërteton se: *Alfred Sali me marrëveshje verbale me firmën “{***}” ShPK, banon në apartamentin nr. {***}, kati {***} me nr. pasurie {***}, të kullës “{***}”, në lagjen “{***}”, Vlorë. Qiraja mujore e rënë dakord mes palëve është 20.000 lekë në muaj. Nga informacioni i administruar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë⁸ nuk rezultojnë të dhëna për pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit apo familjarëve të tij në këtë zyrë. Ndërsa, nga verifikimet e kryera nga Komisioni në drejtim të konfliktit të interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, administratorët e ortakët e saj nuk kanë rezultuar çështje të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit me palë këta shtetas⁹.**

13.5 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës: *Duket se marrëdhënia e subjektit me shoqërinë “{***}” ShPK nuk është një*

⁷ Procesverbal “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive” i datës 11.01.2016 dhe datës 20.01.2016 përçjellë në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 11.02.2020.

⁸ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 24.07.2017, nga ZVRPP-së Vlorë dhe shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.03.2020, e ASHK-së Drejtoria Vendore Vlorë.

⁹ Shkresë nr. {***} prot., datë 05.05.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe shkresë {***} prot., datë 29.04.2022, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.

marrëdhënie qiraje, por është një marrëdhënie huapërdorjeje pakundërshtëpërblim. Veprimet e ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit me plotësimin e deklaratës vetting e në vijimësi, duken të tilla për të fshehur këtë marrëdhënie huapërdorjeje midis subjektit dhe shoqërisë tregtare “{***}” ShPK. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Kontrata e qirasë mes palëve ka qenë dhe është me afat 1 vit, duke u përsëritur çdo fillim viti për periudhën 2014, 2015, 2016 e në vijim, sipas marrëveshjes verbale të palëve. Pra, duke qenë se kontratat verbale kanë qenë me afat 1 vit, duke u ripërsëritur, çdo fillim viti, nuk jemi në kushtet e parashikuara nga neni 803, paragrafi 4 i Kodit Civil, që parashikon se “Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë”. [...] Në lidhje me konkluzionet e grupit të punës, i cili e klasifikon këtë marrëdhënie si huapërdorje, prapësoj se marrëdhënia është bazuar në vullnetin e të dy palëve ku është rënë dakord që pagesa të bëhej cash, në fillim të çdo muaji në vleftën 20.000 lekë. Pra, për përdorimin e sendit ka një pagesë mujore për qiranë e banesës, çka vërtetohet nga vërtetimi i shoqërisë “{***}” ShPK, i cili mban datën 29.01.2020, por edhe vërtetim i datës 02.07.2021, të cilat bëjnë fjalë për të njëjtën vleftë pagese qiraje për apartamentin. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vërtetimin e shoqërisë “{***}” ShPK të datës 02.07.2021, nënshkruar nga administratorja D. F., sipas së cilit vërtetohet se: Alfred Sali ka banuar në apartamentin nr. {***}, kati i {***}-të, me nr. pasurie {***} të kullës “{***}”, në lagjen “{***}”, Vlorë, prej datës 01.01.2017 – deri më datë 31.12.2020. Çdo vit në janar është bërë marrëveshje verbale midis tij dhe firmës “{***}”, me administratore znj. D. F. Qiraja mujore që është rënë dakord mes palëve ka qenë 20.000 lekë në muaj.*

14. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të konstatuara më lart, trupi gjykues, fillimisht, vëren se Komisioni, teksa arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka fshehur marrëdhënien e huapërdorjes pakundërshtëpërblim me shoqërinë “{***}” ShPK, nuk ka përcaktuar qartë përgjegjësinë disiplinore që duhet t’i atribuohet subjektit të rivlerësimit në këtë rast e as pasojën ligjore, sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues vëren, gjithashtu, se qëndrimi i Komisionit në vendim, lidhur me vlerësimin e marrëdhënies së subjektit të rivlerësimit me pasurinë në fjalë, paraqitet kontradiktor, pasi nga njëra anë Komisioni e konsideron këtë marrëdhënie si një marrëdhënie huapërdorjeje pakundërshtëpërblim, ndërsa nga ana tjetër përfshin në analizën financiare¹⁰, në zërin shpenzime qiraje për periudhën 2014-2017, shumë prej 240.000 lekësh për çdo vit, duke konfirmuar në këtë mënyrë marrëdhënien e qirasë. Konkluzionin e tij, për ta konsideruar marrëdhënien mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, për periudhën 2014-01.01.2017, si huapërdorjeje pakundërshtëpërblim, trupi gjykues vëren se Komisioni e ka mbështetur, së pari, në argumentin e mosdeklarimit nga ana e subjektit të rivlerësimit të së drejtës reale të përdorimit të pasurisë përmes marrëdhënies së qirasë apo huapërdorjes në deklaratat e interesave private periodike për periudhën 2014 e në vijim, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003. Në drejtim të këtij argumenti, trupi gjykues, referuar nenit 4, shkronja “a” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, vëren se objekt i deklarimit pranë ILDKPKI-së janë, ndër të tjera, edhe të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme. Në rastin konkret, nga verifikimi i formularëve të deklaratave periodike të pasurisë për vitet 2014-2015, rezulton se subjekti ka deklaruar si adresë banimi: *Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Vlorë*, që përkon pjesërisht me adresën e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting¹¹ dhe adresën e pasqyruar në dokumentet e pronësisë paraqitur bashkëlidhur kësaj deklarate, ndërkohë që nuk rezulton e deklaruar marrëdhënia e qirasë/interetit me shoqërinë

¹⁰ Tabelë e analizës financiare në faqen 29 të vendimit.

¹¹ Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Kulla {***}, Kati {***}, Vlorë.

“{***}” ShPK, sipas kërkesave të formularit të deklaratës respektive. Pra, vihet re se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një marrëdhënie përdorimi me pasurinë në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, nëpërmjet deklarimit të adresës së vendqëndrimit alternativ në deklaratën e pasurisë *vetting*, por edhe në deklaratat periodike për vitet 2014-2016. Në këto rrethana, pavarësisht pasaktësive, në kuptim të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, për shkak të mosdeklarimit të marrëdhënies së interesit me shoqërinë “{***}” ShPK, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit përmes deklarimit të kësaj marrëdhënieje përdorimi ka lejuar organet e rivlerësimit, por edhe ILDKPKI-në, që përgjatë viteve 2014-2016 të verifikojnë dhe kontrollojnë të drejtat e subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri, në përmbushje të detyrimeve ligjore.

15. Në vijim të sa më lart, trupi gjykues vëren se argumenti tjetër mbi të cilin Komisioni ka mbështetur konkluzionin e tij lidhet me mungesën e provueshmërisë së marrëdhënies së qirasë, duke iu referuar vërtetimit të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 02.07.2021, të paraqitur me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, i cili konfirmon marrëdhënien e qirasë vetëm për periudhën 01.01.2017-31.12.2020. Në drejtim të këtij argumenti, ndonëse Komisioni ka pranuar faktin që subjekti nuk ka qenë në kushtet e detyrimit të parashikuar nga neni 803 i Kodit Civil, për formalizimin e saj me shkrim, sa kohë që kjo marrëdhënie qiraje ka qenë njëvjeçare dhe është ripërtërirë çdo vit¹², trupi gjykues konstaton se gjatë hetimit administrativ Komisioni ka administruar tre vërtetime nga shoqëria “{***}” ShPK, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në kohë të ndryshme, respektivisht i pari që i përket datës 19.01.2016 depozituar nga subjekti pranë ILDKPKI-së rreth 8 muaj përpara miratimit të ligjit nr. 84/2016 dhe 1 vit përpara dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, si dhe dy të tjerë të datave 29.01.2020 dhe 02.07.2021, të paraqitura gjatë dhe në përfundim të hetimit administrativ. Të tria këto vërtetime konfirmojnë më së paku faktin se subjekti i rivlerësimit ka banuar me qira në apartament në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, edhe përpara datës 01.01.2017, dhe jo vetëm pas kësaj date.
16. Bazuar në sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i marrëdhënies së qirasë/interesit me shoqërinë “{***}” ShPK në deklaratat e viteve 2014 dhe 2015 dhe deklarimi i saj për herë të parë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe DIPP-në e vitit 2016, janë të pamjaftueshme për të arritur në konkluzionin se ato kanë shërbyer për fshehjen e marrëdhënies së vërtetë mes subjektit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, sa kohë që në sajë të deklarimeve të subjektit të adresës së vendqëndrimit “*Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Vlorë*”, ILDKPKI-ja kishte mundësi në çdo kohë të verifikonte marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me apartamentin e ndodhur në këtë adresë dhe pronarin e saj. Në këtë vlerësim, trupi gjykues mbajti në konsideratë se: (i) subjekti i rivlerësimit në periudhën objekt kontrolli ka pasur në përdorim një apartament në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK; (ii) përdorimi i apartamentit në formën e qirasë nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Kodit Civil apo legjislacionit të posaçëm lidhur me deklarimin e pasurive dhe interesave private; (iii) Komisioni ka pranuar faktin se marrëdhënia e qirasë ka qenë njëvjeçare dhe është ripërtërirë çdo vit e, si e tillë, nuk i nënshtrohej detyrimit të parashikuar nga neni 803 i Kodit Civil, për formalizimin e saj me shkrim; (iv) marrëdhënia e krijuar me shoqërinë “{***}” ShPK nuk rezultoi nga hetimi administrativ të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit¹³ të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e zyrtarit, sipas parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi e as të jetë

¹² Paragrafët 2.11 dhe 2.12 të vendimit të Komisionit.

¹³ Paragrafi 2.6 i vendimit të Komisionit.

kualifikuar nga Komisioni si trajtim preferencial në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar¹⁴. Për këto arsye, trupi gjykues arrin në përfundimin se hetimi i kryer dhe argumentet e Komisionit në vendimin e tij mbi marrëdhënien objekt shqyrtimi nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme për konkluzione në drejtim të fshehjes së marrëdhënies së huapërdorjes pakundërshtëpërblim mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” ShPK.

Shuma prej 58.000 eurosh, dhënë hua babait L. S. me kontratë verbale, pa afat dhe likuiditete cash në vlerën 9.000 euro

17. Komisioni ka arritur në përfundimin se: (i) mosdeklarimi në asnjë deklaratë i destinacionit të shumës 75.854 euro të përfituar nga lojërat e fatit online, si dhe i gjendjes cash të kësaj shume në DIPP-të ndër vite, pasi subjekti i tërhoqi menjëherë ato nga llogaria e tij bankare; (ii) marrja e kredisë bankare në shumën 1.200.000 lekë në “Raiffeisen Bank” në datën 11.04.2016, kur ndërkohë subjekti pretendon se ka pasur një gjendje të konsiderueshme cash në banesë, të paktën prej 58.000 euro +9.000 euro; (iii) ekzistenca e një kredie personale në shumën 728.000 lekë në Raiffeisen Bank që nga viti 2013 e deri pas fitimit të lotarisë, e cila nuk është shlyer me shumën e fituar në lojëra fati, por është shlyer në vazhdimësi deri në vitin 2016 me një kredi tjetër; (iv) mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2016 i huas në shumën 58.000 euro që subjekti i dha babait; (v) mospagimi në kohë i detyrimi tatimor për shumën 75.854 euro, si e ardhur e përfituar nga lojërat e fatit online; (vi) deklarimi i pasaktë në lidhje me gjendjen cash në shumë 9.000 euro në deklaratën vetting; (vii) dorëzimi i DIPP-së të vitit 2016 në ILDKPKI pas asaj të deklaratës vetting dhe mospasqyrimi në të i gjendjes cash dhe i huas dhënë babait të tij – krijoi bindjen mbi mosekzistencën reale të shumës 75.854 euro së fituar në lojëra fati, pas momentit të tërheqjes fizike nga banka prej subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë vetting lidhur me dhënien e huasë prej 58.000 euro babait të tij dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për dhënien e saj dhe për krijimin e gjendjes cash në shumën 9.000 euro. Komisioni nuk ka përcaktuar pasojën ligjore që i atribuohet subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
18. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm, duke parashtruar në ankim argumentet si vijojnë.

18.1 Në të kundërt të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni ka pranuar në vendim se shuma prej 75.860 eurosh është përfituar përmes transfertës së bërë nga llogaria e tij pranë kompanisë “{***}”, tek llogaria e tij bankare pranë Raiffeisen Bank ShA. Nga ana e tij janë deklaruar të ardhurat nga lojërat e fatit në shumën bruto prej 11.063.850 lekësh, në deklaratën individuale të të ardhurave DIVA për vitin 2014, si dhe është kryer vetëdeklarim pranë DRT-së Vlorë për shumën e tatimit të llogaritur në vlerën 1.111.462 lekë (7.900 euro). Pagesa e detyrimeve tatimore është bërë në muajin janar 2017, pasi ka pasur një paqartësi lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga një burim jashtë Shqipërisë, derisa është informuar në fund të vitit 2016 fillim i vitit 2017 se referuar rregullores së shoqërisë pagimi i detyrimeve tatimore ishte detyrim i secilit pjesëmarrës dhe rregullohej sipas legjislacionit kombëtar;

¹⁴ Në nenin 23 të këtij ligji, i ndryshuar, përcaktohet se: “[...] është e ndaluar që një zyrtar të kërkojë ose të marrë, në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë, dhurata, favore, premtime ose trajtime preferenciale, të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij, nga një individ, person fizik ose juridik privat”.

18.2 Nuk ka pasur ndonjë parashikim ligjor mbi mënyrën e disponimit të shumës 75.860 euro pas tërheqjes së saj nga Raiffeisen Bank ShA e as detyrim ligjor për vlerën *cash*, që duhet të mbahet jashtë sistemit bankar në këndvështrim të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, për sa kohë që ai është deklarues që prej vitit 2004 dhe jo deklarues për herë të parë në kuptim të nenit 4/1 të të njëjtit ligj;

18.3 Me deklarin e shumës së fituar nga lojërat e fatit në DIPP-në e vitit 2014 dhe DIVA 2014, është menduar se deklarimi ka qenë i mjaftueshëm dhe në zbatim të parashikimeve ligjore, ndërsa mospasqyrimi i shumës së tërhequr nga banka si gjendje *cash*, lidhet me moskuptimin e drejtë ose të kuptimit të gabuar të parashikimit ligjor mbi deklarin e pakësimit ose shtimit të gjendjes *cash*. Ky fakt, sipas tij, dëshmohe nga deklaratat e interesave private periodike që prej vitit 2003, në të cilat janë pasqyruar vetëm shtesa kursimesh të ardhura nga paga, dhe se detyrimi për deklarin e gjendjes *cash* i është bërë me dije gjatë intervistimit në ILDKPKI në vitin 2017;

18.4 Nga ana e tij dhe e bashkëshortes është vlerësuar që shuma e disponuar prej tyre *cash*, e fituar në lojë fati, të ruhej e paprekur me qëllim kryerjen e ndonjë investimi të mëvonshëm, ndërkohë që kreditë e marra në kohë kanë qenë kredi konsumatore dhe janë përdorur për shpenzime familjare në vijimësi, pasi që prej muajit janar të vitit 2014 e në vijim bashkëshortja e tij është larguar nga puna dhe në familjen e tij ka pasur vetëm një person të punësuar;

18.5 Provat e administruara në fazën e hetimit administrativ vërtetojnë se shuma e përfituar nga lojërat e fatit është tërhequr nga banka dhe i është dhënë babait në vitin 2016. Kjo shumë nuk është shpenzuar prej tij, pasi nga hetimi nuk rezultoi asnjë veprim juridik në drejtim të blerjes/investimit të ndonjë pasurie të paluajtshme, asnjë transfertë bankare apo investim në atë vlerë apo vlerë të përafërt;

18.6 Mosdeklarimi i shumës së dhënë hua babait në DIPP-në e vitit 2016 ka qenë një harresë nga ana e tij, gjë që konfirmohet nga: deklarimi i bërë në DIPP-në e vitit 2017; nga të dhënat e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank ShA të datës 14.12.2020, lidhur me kthimin e shumës së marrë hua nga babai; deklarata noteriale e babait L. S. e datës 26.01.2017; si dhe deklarata noteriale e bashkëshortes E. S. e datës 14.07.2022.

19. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit në drejtim të argumenteve që kanë të bëjnë me përfitimin e të ardhurës së buruar nga lojërat e fatit dhe pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me të, pasqyruar në paragrafin 18.1 më lart, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet në fashikullin e hetimit administrativ dhe arsyetimin e Komisionit në vendim, konstaton se:

19.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*¹⁵, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Likuiditete cash në monedhën euro. Burimi i krijimit, lojë fati online. Vlera: 9.000 euro. Pjesa takuese: 100%; dhe Shumë prej 58.000 eurosh dhënë hua shtetasit L. S. (babai), kontratë verbale, pa afat, me qëllim përfundimin e punimeve të ndërtimit për pajisje me akt kolaudimi, leje shfrytëzimi, pagim detyrimesh tatimore dhe regjistrim pranë ZVRPP-së (shih deklaratë noteriale nr. {***} rep., datë 26.01.2017). Objekti banesë lagjja Nr.{***}, Sarandë, leje ndërtimi vendim i KRRt-së Bashkia Sarandë nr. {***}, datë 07.10.2006 (e papërfunduar). Burimi i krijimit të shumës të*

¹⁵ Deklarata e pasurisë *vetting* është dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 29.01.2017.

dhënë hua, lojë fati online. Vlera: 58.000 euro. Pjesa takuese: 100%. Bashkëlidhur kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, ndër të tjera, dokumentet:

- i) akt bankar “tërheqje nga llogaria” në Raiffeisen Bank ShA, Dega Nr. {***}, Vlorë, sipas së cilës ka tërhequr më datë 19.03.2014, shumën prej 75.854 eurosh;
- ii) shkresë kthim përgjigje nga kompania “{***}” e datës 25.10.2016, në gjuhën angleze¹⁶, sipas së cilës konfirmohet se shtetasi Alfred Sali ka fituar *Jackpot* në shumën 75.000 euro në shkurt të vitit 2014, shoqëruar me gjendjen e lëvizjes në llogari të subjektit për periudhën 01.01.2014-31.03.2014, në të cilën evidentohen tre transaksione bankare të datës 27.02.2014, përkatësisht në vlerat 40.000 euro, 33.000 euro dhe 3.000 euro, në vlerën totale prej 76.000 eurosh;
- iii) e-mail nga kompania “{***}” drejtuar subjektit të rivlerësimit, në gjuhën angleze¹⁷, sipas të cilës konfirmohet se ai ka fituar *Jackpot* në lojën {***} në shumën 65.059.27 GBP, shumë e cila do të shtohet në llogarinë e tij në vlerën 79.027,5 euro;
- iv) deklaratë individuale e të ardhurave për vitin 2014 (në vijim “DIVA”), në të cilën deklarohet vlera *bruto* 11.063.850 lekë, e përfituar nga lotari apo lojëra fati;
- v) vërtetim nr. {***} prot., datë 27.01.2017, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë (në vijim “DRT Vlorë”), sipas së cilit vërtetohet se në bazë të vetëdeklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit nuk rezultojnë detyrime tatimore.

19.2 Në DIPP-në e vitit 2014, në rubrikën “*Të ardhurat dhe angazhimet në veprimtari publike dhe/ose private*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Të ardhura nga lojë fati online www.{***}.com. Adresa e shoqërisë “{***}”, Zyrë regjistrimi: {***}, England, U.K. Company no: {***}. Gjibraltar: {***} (Gibraltar) Limited: Registered Office: Unit 1.1. {***}, {***}. {***}: Gibraltar. Registered in Gibraltar With company no: {***}. Shuma është tërhequr pranë Raiffeisen Bank më datë 19.03.2014, në llogarinë nr. {***}. Vlera: 79.027,50 euro.*

19.3 Në DIPP-në e vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pagim detyrimi tatimor në vlerën 1.250.000 lekë pranë DRT-së Vlorë si subjekt i ligjit nr. 8438/1998 (viti 2014 shih DIPP-në 2015). Shuma e detyrimit të llogaritur 1.111.462 lekë (7.900 euro+ interesat deri në datën 11.01.2017. Burimi i krijimit të shumës e ardhur nga lojë fati online (krijuar vitit 2014, shih DIPP-në 2015). Pjesa: 100%.*

19.4 Gjatë hetimit administrativ, nga informacioni i përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave¹⁸ rezulton se subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e tij në Raiffeisen Bank ShA në datën 19.03.2014 shumën prej 75.854 eurosh, me burim një transfertë në shumën 75.860 euro, nga subjekti “{***}”, në Angli, e cila i përkiste një kompanie bastesh. Nga informacioni i përcjellë nga DRT-ja Vlorë¹⁹, rezulton se subjekti është regjistruar pranë kësaj drejtorie në datën 28.4.2015 dhe në datën 30.4.2015 ka deklaruar të ardhura *bruto* nga lojëra fati në shumën 11.063.850 lekë, si dhe ka paguar për këtë shumë tatimin në vlerën 1.250.000 lekë në datat 27.1.2017 dhe 30.1.2017.

19.5 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës: *Duket e dyshimtë transfertat e shumës 75.860 euro në llogarinë e subjektit të*

¹⁶ Përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nga avokat dhe përkthyes ligjor I. Z.

¹⁷ Përkthyer nga gjuha angleze në gjuhën shqipe nga avokat dhe përkthyes ligjor I. Z.

¹⁸ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.05.2017, e DPPPP-së drejtuar ILDKPKI-së.

¹⁹ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 19.05.2022, e DRT-së Vlorë.

rivlerësimi në Raiffeisen Bank, për sa kohë nuk provohet dërgimi i saj nga llogaria e lojtarit, si dhe nisur nga tërheqja e saj menjëherë, mosshlyerja e detyrimeve tatimore në kohën e përfitimit (pagimi i tyre duket se është bërë për efekt të deklaratës vetting dhe duket se shuma 1.250.000 lekë e paguar si tatim mbi të ardhurat nga lojërat e fatit nuk mund të ketë si burim krijimi këto të ardhura), mosdeklarimi i destinacionit të shumës së tërhequr për të gjithë periudhën deri në plotësimin e deklaratës vetting. Në kundërshtim të kësaj barre prove, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se fillimisht ka menduar se detyrimet tatimore nuk ishin detyrim i tij si përfitues, pasi e ardhura ishte përfituar nga një burim jashtë Shqipërisë e, për këtë arsye, ishte mjaftuar vetëm me deklarimin e të ardhurave pranë autoritetit tatimor. Më tej, ka shpjeguar se pasi është njohur me rregulloren e shoqërisë në fund të vitit 2016, fillim i vitit 2017, është vënë në dijeni se pagimi i detyrimeve tatimore për çdo të ardhur të realizuar nga kjo kompani ishte detyrim i secilit pjesëmarrës dhe rregullohej nga legjislacionet kombëtare. Ky është shkaku, sipas tij, që pagesa e detyrimeve tatimore është kryer në muajin janar 2017.

20. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shoqëria “{***}”, pranë organeve tatimore në kuadër të plotësimit të deklaratës DIVA për vitin 2014, më datë 30.04.2015, duke e bërë një fakt të deklaruar në kohë, ndërkohë që pagesa respektive është kryer pas afërsisht dy vitesh, në datat 27 dhe 30.01.2017 (pothuaj në të njëjtën kohë me dorëzimin e deklaratës së pasurisë *vetting*). Ndonëse mospagimi në kohë i detyrimit tatimor për shumën prej 75.854 eurosh përfituar nga lojërat e fatit *online*, është renditur nga Komisioni si një ndër argumentet që kanë çuar drejt konkluzionit për mosekzistencën reale të shumës 75.854 euro së fituar në lojëra fati pas momentit të tërheqjes fizike nga banka, trupi gjykues vëren se Komisioni, qoftë në analizën financiare të rezultateve të hetimit, qoftë në analizën financiare të vendimit, ka përfshirë në mesin e të ardhurave të ligjshme për vitin 2014 shumën prej 11.072.473 lekësh nga lojërat e fatit. Pavarësisht arsyetimit kontradiktor, trupi gjykues vëren se Komisioni, me përfshirjen e kësaj të ardhure në mesin e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për vitin 2014, nuk ka vënë në dyshim ekzistencën dhe ligjshmërinë e kësaj të ardhure, por disponueshmërinë e saj nga subjekti i rivlerësimit pas tërheqjes së saj nga banka në vitin 2014 dhe përdorimin si burim krijimi për huanë e dhënë babait në fund të vitit 2016, si dhe gjendjen *cash* prej 9.000 eurosh të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

21. Në shqyrtim të shkakut të ankimit në drejtim të argumenteve të subjektit të rivlerësimit mbi disponimin e shumës prej 75.860 eurosh pas tërheqjes së saj nga Raiffeisen Bank ShA në datën 19.03.2014, deri në fund të vitit 2016, si dhe përdorimin e saj si burim krijimi për huanë e dhënë babait në vlerën 58.000 euro dhe gjendjen *cash* në vlerën 9.000 euro, trupi gjykues nga aktet në fashikull konstaton se:

21.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për likuiditetin *cash* në shumën 9.000 euro dhe huan e dhënë babait në shumën 58.000 euro, të ardhura nga lojë fati *online*. Në DIPP-në e vitit 2014, në rubrikën e deklarimit të të ardhurave, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të përfituara nga lojërat e fatit në shumën 79.027,50 euro, të cilat i ka tërhequr nga Raiffeisen Bank ShA më datë 19.03.2014. Në rubrikën “*Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit*” të kësaj deklarate, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtim të likuiditetit në *cash*. Në rubrikën “*Shpenzimet e deklarueshme*”, të po kësaj deklarate, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar shpenzime me vlerë mbi

300.000 lekë²⁰. Në DIPP-të e viteve 2015 dhe 2016 nuk rezulton që në rubrikat respektive të jetë deklaruar shtim likuiditeti në *cash* apo shpenzime mbi vlerën 300.000 lekë;

21.2 Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në datat 11.01.2016 dhe 20.01.2016, i pyetur mbi mosdeklarimin e tërheqjes së shumës prej 79.027 eurosh të përfituar nga lojërat e fatit më datë 10.03.2014 dhe destinacionin e përdorimit, si dhe arsyen e tërheqjes së saj nga sistemi bankar për ta disponuar si gjendje *cash* në shtëpi, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Nuk kam qenë në dijeni të faktit që duhej deklaruar tërheqja dhe destinacioni i tyre. Duke qenë se tërheqja e fondeve është bërë në një periudhë shumë të shkurtër kohore, është menduar thjesht si një transaksion dhe është ezauruar ky detyrim ligjor në këtë pjesë. Shuma e tërhequr nga banka është mbajtur në shtëpi në gjendje cash. [...] Kam menduar për ta depozituar në një kohë të vonshme në një bankë me interesa më të larta depozitimi, veprim ky i cili nuk është kryer ende deri në ditët e sotme. Në përgjigje të kërkesës së ILDKPKI-së për të depozituar në bankë shumën prej 79.027 eurosh, duke paraqitur mandatin e kryerjes së depozitimit bankar, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: Në dijeninë time, nuk ka qenë detyrim ligjor në kohën e përfitimit të kësaj shume. Ndryshimet ligjore që kanë dalë pas përfitimit të kësaj shume, në vlerësimin tim, nuk kanë efekt prapaveprues nga momenti i hyrjes së ligjit. Ligji e parashikon si detyrim për personat që kryejnë deklarimin “para fillimit të detyrës” dhe unë nuk jam në këto kushte. Gjithashtu, nuk e parashikon si detyrim për personat që kryejnë deklarimin periodik. Duke qenë se kërkohet nga ana Juaj, vënia në dispozicion e dokumentit të depozitimit bankar të kësaj shume, shpjegoj se është një shumë e përfituar në rrugë bankare dhe për këtë shkak do Ju vë në dispozicion dokumentacionin në lidhje me tërheqjen e kësaj shume nga Raiffeisen Bank. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë ILDKPKI-së aktin bankar për tërheqjen nga llogaria pranë Raiffeisen Bank ShA më datë 19.03.2014 të shumës 75.854 euro, paraqitur edhe bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting.*

21.3 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni mbi mbajtjen *cash* të vlerave monetare mbi 1.500.000 lekë dhe jo në sistemin bankar, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar²¹ se kjo mënyrë është gjykuar më e arsyeshme prej tij, për shkak edhe të interesave të ulët që ofronin bankat për mbajtjen e depozitave në monedhë të huaj, ndërkohë që në dijeninë e tij nuk ka pasur detyrim ligjor për vlerën *cash* që mbahet jashtë sistemit bankar, pasi neni 4/1 i ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, ka parashikuar një detyrim të tillë vetëm për subjektet e ligjit që plotësojnë deklarimin për herë të parë;

21.4 Në përfundim të hetimit administrativ, pasi u njoh me konstatimin e Komisionit për mosdeklarimin e destinacionit të shumës 75.854 euro të përfituar nga lojërat e fatit online, si dhe i gjendjes *cash* të kësaj shume në DIPP ndër vite pas tërheqjes së tyre nga llogaria bankare, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se më datë 19.03.2014 ka tërhequr nga llogaria e tij në Raiffeisen Bank ShA shumën prej 75.854 eurosh, të cilën e ka mbajtur *cash* sa kohë që nuk ka pasur ndonjë detyrim ligjor mbi mënyrën e disponimit të saj. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.07.2022, të bashkëshortes E. S., në të cilën ajo konfirmon deklaratimet e subjektit të rivlerësimit mbi mbajtjen *cash* të shumës prej 75.000 eurosh të tërhequr nga Raiffeisen Bank ShA në vitin 2014, si dhe dhënien nga kjo shumë të vlerës prej 58.000 eurosh hua vjehrrit në

²⁰ Me ndryshimet e ligjit nr. 9049/2003, me ligjin nr. 45/2014, datë 24.04.2014, u parashikua detyrimi për deklarimin e shpenzimeve në vlerën mbi 300.000 lekë.

²¹ Përgjigjet e pyetësorit nr. {***}.

muajin dhjetor të vitit 2016, shumë e cila iu është kthyer po në rrugë bankare prej tij në fund të vitit 2020.

22. Bazuar në sa më sipër, në drejtim të argumentit të subjektit të rivlerësimit se *nuk ka pasur ndonjë parashikim ligjor mbi mënyrën e disponimit të shumës 75.860 euro, pas tërheqjes së saj nga Raiffeisen Bank ShA, e as detyrim ligjor për vlerën cash, që duhet të mbahet jashtë sistemit bankar në këndvështrim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003*, nga analizimi i kuadrit ligjor, lidhur me detyrimin e subjekteve deklarues për deklarim të pasurisë dhe interesave private, trupi gjykues vëren se sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, subjektet deklarues duhet të deklaronin pranë organit kompetent, ndër të tjera, edhe vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, si dhe çdo veprimtari tjetër që ka sjellë të ardhura personale. Detyrimi i deklarimeve të *cash*-it në çfarëdo vendndodhje dhe vlere ka qenë qartazi i parashikuar që në ligjin nr. 9049/2003 dhe ndryshimet e sjella në vitin 2014²² vetëm shtuan togfjalëshin sqarues “jashtë sistemit bankar”. Ky detyrim ligjor është reflektuar edhe në kërkesat e formularit të deklaratës respektive, e cila kërkon, ndër të tjera, edhe përshkrimin e shtesave apo pakësimeve të gjendjes *cash*. Në vlerësim të përmbushjes së këtij detyrimi ligjor në rastin konkret, trupi gjykues vëren se në DIPP-në e vitit 2014 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga lojëra fati *online* nga shoqëria “{***}”, në vlerën 79.027.50 euro, duke përmbushur detyrimin për deklarimin e kësaj shume si të ardhur, ndërkohë që nuk rezulton të jetë përmbushur detyrimi tjetër ligjor për deklarimin e kësaj shume si shtim *cash*-i pas tërheqjes së saj nga banka në datën 19.03.2014. Ky detyrim ligjor nuk rezulton të jetë përmbushur as në DIPP-në vijuese të vitit 2015. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në DIPP-të e viteve 2014 dhe 2015, për shkak të mosdeklarimit të disponimit të gjendjes *cash* të shumës së përfituar nga lojërat e fatit, sipas parashikimeve të nenit 4, shkronja “d” e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar.
23. Lidhur me argumentin e subjektit të rivlerësimit se nga ana e tij nuk është kuptuar drejt parashikimi ligjor për deklarimin e *cash*-it, pakësimin apo shtimin e tij, fakt që sipas tij dëshmohet nga deklaratat vjetore të pasurisë që prej vitit 2003, në të cilat janë pasqyruar vetëm shtesa kursimesh nga paga, trupi gjykues, nga leximi i DIPP-ve të depozituara ndër vite pranë ILDKPKI-së që prej vitit 2003, si pasqyruar në paragrafin 29.1 të këtij vendimi, vëren se subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar *gjendje në cash, viti 2006, 150.000 lekë*, ndërsa në deklaratimet vijuese ka deklaruar *kursime nga paga*, pa specifikuar nëse ato janë shtesa/pakësime likuiditeti. Përveç këtij fakti që nuk e mbështet pretendimin e tij për moskuptimin e deklarimit të *cash*-it, trupi gjykues vlerëson se në kushtet e parashikimeve të qarta të ligjit nr. 9049/2003²³ dhe formularit të deklarimeve të interesave private periodike ndër vite, i cili ka udhëzuar zyrtarët deklarues të deklarojnë çdo ndryshim (shtesë/pakësim) të interesave pasurorë, por edhe të përvojës së subjektit të rivlerësimit si magjistrat, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit në këtë drejtim²⁴, e gjen jo të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

²² Sipas ligjit nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë””, shkronja “d” e nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003 ka ndryshuar: “d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar; në llogari rrjedhëse në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lek ose në valutë të huaj”.

²³ Neni 4 parashikon: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] (d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

²⁴ Vendimet e Kolegjit nr. 11/2019, paragrafi 27.12.18; nr. 19/2019, paragrafi 84; nr. 20/2019, paragrafët 55 e 56.

24. Çështja tjetër e marrë në analizë nga trupi gjykues lidhet me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *mosdeklarimi i shumës së dhënë hua babait të tij, në DIPP-në e vitit 2016 ka qenë një harresë nga ana e tij, gjë që konfirmohet nga deklarimi i bërë në DIPP-në e vitit 2017, nga të dhënat e llogarisë bankare pranë Raiffeisen Bank ShA të datës 14.12.2020, për kthimin e huas nga babai, deklarata noteriale e babait L. S. e datës 26.01.2017, si dhe deklarata noteriale e bashkëshortes E. S. e datës 14.07.2022*. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga kontrolli i arsytimit të vendimmarrjes së Komisionit dhe verifikimi i akteve në fashikullin e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

24.1 Subjekti i rivlerësimit, për të mbështetur deklarin e tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, për huanë në vlerën 58.000 euro dhënë babait L. S., ka paraqitur bashkëlidhur saj deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.01.2017, të deklaruesit L. S., i cili ka deklaruar se: *Banoj në lagjen Nr. {***} të qytetit Sarandë, së bashku me familjen time dhe në këtë lagje, unë deklaruesi, kryej që prej vitit 2007 dhe në vazhdim edhe ndërtimin e një objekti “Banesë 4+1 kate”, banesë e cila ndodhet në lagjen Nr.{***}, mbi “{***}” Sarandë, [...]. [...] unë deklaruesi L. S., jam pensionist dhe të ardhurat e mia financiare dhe të bashkëshortes time dhe të fëmijëve të mi me të cilët jetojmë në qytetin Sarandë, janë të pamjaftueshme dhe për të vazhduar ndërtimin e këtij objekti. Për këtë fakt, unë deklaruesi L. S., kam marrë nga ana e djalit tim të quajtur Alfred L. Sali, në muajin dhjetor të vitit 2016 “Borxh” në vlerën prej 58.000 eurosh, vlerë me të cilat unë deklaruesi kam kryer edhe një pjesë të pagesave të personave që kryejnë edhe ndërtimin e objektit tim “Banesë 4+1 kate” në lagjen Nr. {***}, në qytetin Sarandë. Së bashku me këtë deklaratë është paraqitur edhe leje ndërtimi me subjekt ndërtues shoqërinë “{***}” ShPK e miratuar me vendimin nr. {***}, datë 07.10.2006, të KRRt-së për ndërtim banese të financuar nga shtetasi L. S.;*

24.2 Nga verifikimi i DIPP-së së vitit 2016, dorëzuar në ILDKPKI më datë 31.03.2017, pra, pas deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar marrëdhënien e huasë me babain Alfred Sali. Kjo marrëdhënie rezulton të jetë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2017, njësoj si deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*;

24.3 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni mbi arsyen e mosdeklarimit të këtij borxhi në DIPP-në e vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar²⁵ se: *“Mosdeklarimi i shumës së dhënë hua në DIPP-në e vitit 2016 ka qenë harresë nga ana ime, gjë që konfirmohet si i tillë nga fakti që ky deklarim është bërë prej meje në DIPP-në e vitit 2017, ku pasqyrohet se shuma prej 58.000 eurosh i është dhënë hua shtetasit L. S. (baba i subjektit), kontratë verbale, pa afat, pasqyruar dhe në deklaratën noteriale të L. S., me nr. {***} rep., datë 26.01.2017, përpiluar pranë noterit E. K., Sarandë. I pyetur, më tej, mbi mënyrën e dorëzimit të kësaj shume babait të tij, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: Shuma i është dhënë cash babait tim, pasi disponohej si e tillë prej meje, si dhe për shkak të raporteve të posaçme familjare dhe të marrëdhënieve të besimit mes palëve. Përveç deklaratës noteriale nuk disponoj prova të tjera dokumentare. Ju bëj me dije se shuma e dhënë hua, pa interes, në vleftën prej 58.000 eurosh më është kthyer prej shtetasit L. S., më datë 14.12.2020, ku im atë ka kaluar në llogarinë time nr. {***}, në euro, në Raiffeisen Bank shumën prej 58.000 eurosh, hua (sipas deklaratës noteriale nr.{***} rep., datë 26.1.2017), duke u mbajtur edhe komisioni bankar përkatës. Kthimi i shumës është kryer nëpërmjet sistemit bankar, pasi kjo shumë disponohej në*

²⁵ Në përgjigjet e pyetësorit nr. {***}.

bankë, prej tim eti, në kohën e shlyerjes së detyrimit (shih llogari Raiffeisen Bank, Alfred Sali, datë 14.12.2020). Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, subjekti ka paraqitur aktin bankar “Nxjerrje llogarie”, të Raiffeisen Bank ShA, të datës 14.12.2020, sipas së cilit dokumentohet transaksioni financiar i kryer në këtë datë për transferimin e shumës prej 57.930,40 eurosh, nga shtetasi L. S. tek subjekti i rivlerësimit Alfred Sali, me përshkrimin “according to noterial declaration nr. {***}...nr. {***}...”;

24.4 Veç sa më lart, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka kryer verifikime edhe në drejtim të destinacionit të përdorimit të shumës së marrë hua nga babai. Konkretisht, i pyetur nga Komisioni mbi shumat e investuara prej tij dhe familjarëve në ndërtimin e banesës 4+1 kate në qytetin e Sarandës, sipas deklaratës noteriale të babait, si dhe burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] ky objekt është financuar tërësisht me të ardhurat e siguruara në shtetin grek, prej familjes sime të origjinës. [...] duke qenë se prej vitit 2011 dhe deri më sot, ata janë kthyer dhe jetojnë në Shqipëri, për shkaqe financiare, objekti nuk ka përfunduar tërësisht. [...] Nuk disponohet dokumentacion dhe preventiv mbi punimet e kryera prej tyre pasi janë kryer në mënyrë private. Po kështu nuk janë ruajtur faturat e blerjes së lëndëve të para. [...] prej shtetasit L. S. është aplikuar për legalizimin e objektit dhe objekti është pajisur me leje legalizimi në vitin 2017 dhe pasandaj është kryer edhe regjistrimi i objektit në ZVRPP-në Sarandë me nr. pasurie nr.{***}, vol. {***}, fq. {***}, z. k. {***}, në emër të z. L. S., datë 31.01.2018. Ky objekt, sipas kontratës për shitje pasurisë së paluajtshme me rezervë me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.2020 (me kusht kreditimi) [...], si dhe deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.10.2020, i është shitur prej L. S. dhe R. S. (nëna), blerësve B. L. dhe M. S., në vleftën prej 225.000 eurosh. [...] Në lidhje me këtë objekt, deklaroj se prej meje nuk është kryer asnjë investim . Me trungun familjar unë jam ndarë pas martesës sime, në muajin dhjetor 2005, duke u ndarë normalisht dhe ekonomitë familjare. [...]. Me të ardhurat e siguruara në shtetin grek, familja ime e origjinës ka investuar në vendlindje, qytetin e Sarandës, për ndërtimin e këtij objekti. [...] të ardhurat e realizuara (vetëm ato të evidentuara në regjistrat publikë), për periudhën deri në fund të vitit 2007, kapin një vleftë prej 101.225 eurosh, ndërsa të ardhurat e realizuara deri në fund të vitit 2010 (vetëm ato të evidentuara në regjistrat publikë) kohë gjatë së cilës kanë vijuar investimet në objekt kapin një shumë prej 183.392 eurosh. Prej tim eti, jam vënë në dijeni se vlefte e përgjithshme e investimit, të kryer prej tij në objekt kap një shifër jo më të madhe se 100.000 euro. [...].

24.5 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, edhe barrën e provës: [...] Deklarimi i subjektit për huanë e dhënë babait të tij në shumën prej 58.000 eurosh duket i dyshimtë dhe nuk është në harmoni/përputhshmëri me deklaratimet e tij ndër vite apo në lidhje logjike e ekonomike me investimin e kryer/pretenduar, nga babai i tij. [...] dhënia e huasë nuk gjen pasqyrim në deklaratimet periodike të subjektit. Duket se deklarimi i tij për huadhënien në deklaratën vetting është deklarim i rremë. Në kundërshtim të kësaj barre prove, subjekti i rivlerësimit, përveç sa deklaruar gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se: Shuma i është dhënë cash babait tim, pasi disponohej si e tillë prej meje, si dhe për shkak të raporteve të posaçme familjare dhe të marrëdhënieve të besimit mes palëve. [...] arsyet për të cilat është dhënë huaja janë deklaruar si të tilla prej meje çka konfirmohet edhe nga deklarata noteriale tim eti, e marrë si provë gjatë hetimit administrativ, ku prej tij është pasur si qëllim përfundimi i punimeve në objektin në pronësi të tij, si dhe veprimet dhe pagesat për regjistrimin e saj eventualisht, në regjistrat publikë. Në lidhje me rrethanat, parashtroj se prej tim eti më është bërë me dije asokohe se pasi ishte konsultuar dhe

me vëllëzërit, si persona që kishin njohuri në fushën e ndërtimit, ishte bërë një llogaritje paraprake e shumës që u duhej për përfundimin e investimit të tyre, ku më është thënë se për përfundimin e objektit u duhej një e shumë e përafërt me 100.000 - 120.000 euro. Në lidhje me diferencën e shumës, jam vënë në dijeni prej tij, në atë kohë se kishte biseduar dhe shpresonte ta merrte në formë huamarrjeje tek disa persona të afërm, duke qenë se nga pikëpamja e nivelit të të ardhurave në atë kohë nuk plotësonin kushtet për përfitimin e një kredie bankare. Në kohë, jam vënë në dijeni prej tij se i ka vijuar përpjekjet për gjetjen e pjesës tjetër të shumës, që në fakt kanë zgjatur në kohë, por pa sukses, derisa ai ka vendosur të pranojë ofertën e shtetasit B. L. për blerjen e objektit, në pronësi të tij. Për shkak të raporteve familjare, por dhe të faktit se nuk më është nevojitur shuma asokohe, nuk kam kërkuar kthimin e saj. [...]. Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, ndër të tjera, edhe deklaratën noteriale nr. {****} rep., nr. {****} kol., datë 14.07.2022, të bashkëshortes E. S., e cila ka konfirmuar deklaratimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit mbi disponimin në cash të shumës së tërhequr nga Raiffeisen Bank ShA nga bashkëshorti i saj, si dhe dhënien hua nga kjo shumë të vlerës prej 58.000 eurosh babait të subjektit të rivlerësimit.

25. Bazuar në sa më lart, nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se ndër argumentet që kanë çuar Komisionin drejt krijimit të bindjes mbi mosekzistencën reale të shumës prej 75.854 eurosh të fituar në lojëra fati pas momentit të tërheqjes fizike nga banka e, për rrjedhojë, drejt konkluzionit për mungesë të burimeve financiare të ligjshme për dhënien e huasë në shumën prej 58.000 eurosh babait, përbën edhe mosdeklarimi i kësaj huaje, në DIPP-në e vitit 2016. Lidhur me këtë argument, Komisioni ka arsyetuar se²⁶: 5.20. *Komisioni mban në konsideratë edhe faktin se DIPP-ja e vitit 2016 është dorëzuar në ILDKPKI në datën 31.03.2017, pas deklaratës vetting, e cila është dorëzuar në datën 29.01.2017 dhe, çuditërisht, subjekti ka pasqyruar në deklaratën vetting huanë e dhënë babait prej 58.000 euro dhe gjendjen cash prej 9.000 eurosh, por nga ana tjetër nuk i ka pasqyruar këto pasuri në DIPP-në e vitit 2016, megjithëse kjo e fundit është dorëzuar në ILDKPKI pas deklaratës vetting, duke krijuar kështu bindjen e Komisionit se shuma prej 75.000 eurosh nuk ka ekzistuar si gjendje cash e mbartur ndër vite, po ashtu edhe huadhënia e babait të tij prej 58.000 eurosh nuk është reale. Ndërkaq, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, nuk ka arsyetuar dhe potencuar në renditjen finale të argumenteve që kanë çuar drejt arritjes së konkluzionit të mësipërm, argumentin tjetër mbi mungesën e një lidhjeje logjike e ekonomike të huasë së dhënë babait me investimin e kryer/pretenduar, nga babai i tij, pas verifikimeve të kryera në këtë drejtim.*
26. Në analizë të fakteve dhe rrethanave të mësipërme, trupi gjykues, njësoj si Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 shumën e dhënë hua babait të tij dhe marrëdhënien e interesit me të, sipas përcaktimeve të nenit 4, shkronja “d” të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe kërkesave të formularit të deklaratës respektive në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”. Deklarimi i kësaj marrëdhënieje në DIPP-në e vitit 2017, ndonëse del jashtë fokusit të analizës dhe kontrollit të Komisionit, çmohet nga trupi gjykues pa ndikim në rrethanat e faktit dhe nuk e zhbën karakterin deklarativ të pretendimit të subjektit se mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2016 ka qenë një harresë/lapsus. Edhe deklaratat noteriale të babait dhe të bashkëshortes, paraqitur respektivisht me deklaratën e pasurisë vetting dhe gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe transferta bankare e shumës prej 57.930,40 eurosh nga shtetasi L. S. te subjekti i rivlerësimit, në datën 14.12.2020, pas deklaratës vetting, të pambështetura nga provat e tjera të administruara, konsiderohen pa efekt provues në këtë proces në drejtim të

²⁶ Në paragrafin 5.20, faqe 21 e vendimit.

marrëdhënies së huasë. Në këto rrethana, trupi gjykues e çmon të drejtë qëndrimin e Komisionit lidhur me marrëdhënien e huasë, ndërkohë që ekzistenca e saj, bazuar në konkluzionet e mësipërme, sërish nuk do të ishte përcaktuese në drejtim të faktit nëse shuma prej 58.000 eurosh është disponuar në *cash* nga ana e subjektit deri në vitin 2016.

27. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *deklarimi i tij që shuma e përfituar nga lojërat e fatit është tërhequr nga banka dhe i është dhënë babait në vitin 2016, vërtetohet edhe nga fakti se nga hetimi administrativ i Komisionit nuk rezultoi ndonjë veprim juridik në drejtim të blerjes/investimit të ndonjë pasurie të paluajtshme, transfertë bankare apo investim në atë vlerë apo vlerë të përafërt*, trupi gjykues, referuar nenit 4²⁷, shkronja “h” të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, vëren se objekt i deklarimit pranë ILDKPKI-së nga zyrtarët deklarues është edhe çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300.000 lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit. Në rastin konkret nga verifikimi DIPP-ve të viteve 2014 dhe 2015, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë lloj shpenzimi mbi këtë vlerë apo më të vogël. Në këto rrethana, ndonëse nga hetimi administrativ nuk kanë rezultuar veprime juridike në drejtim të blerjes apo investimit të ndonjë pasurie në atë vlerë apo të përafërt, trupi gjykues, në kushtet e mosdeklarimit të ndonjë shpenzimi të tillë dhe destinacionit të saj sipas dispozitës së sipërcituar, si dhe në kushtet e mosdeklarimit të kësaj shume si likuiditet në *cash*, vlerëson se një fakt i tillë nuk mund të prezumojë automatikisht faktin se shuma e tërhequr nga banka në vitin 2014 është disponuar si gjendje *cash* deri në fund të vitit 2016. Në funksion të këtij argumenti, trupi gjykues nuk përjashton as mundësinë që shuma objekt shqyrtimi të jetë shpenzuar për jetesën e përditshme sa kohë që standardi i INSTAT-it i aplikuar për shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit, si për çdo subjekt tjetër, përcakton pragun minimal të shpenzimeve jetike, por nuk konfirmon në mënyrë absolute që ato kanë qenë shpenzimet reale të jetesës së tij në këto vite.
28. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *fakti që ai ka marrë disa kredi konsumatore, të cilat janë përdorur për shpenzime familjare në vijimësi, nuk cenon logjikën ekonomike*, trupi gjykues vëren se Komisioni gjatë hetimit administrativ i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë sqarime lidhur me faktin se në kushtet kur ai ka disponuar një shumë të madhe nga lojërat e fatit, duket jashtë çdo logjike ekonomike marrja e një kredie në Raiffeisen Bank, në prill të vitit 2016, në vlerën 1.200.000 lekë, marrja e një kredie në Union Bank, në vitin 2015, në vlerën 54.900 lekë, hapja e një llogarie overdraft në vitin 2015 në Raiffeisen Bank në shumën 70.000 lekë, si dhe vazhdimi i pagimit të kredisë prej 728.000 lekësh, të marrë në vitin 2013. Në përgjigje të kësaj kërkesë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se²⁸: *Kredia në Union Bank është marrë me qëllim blerjen e një kompjuteri lap-top për vajzën time, ku oferta është gjykuar prej meje si më e përshtatshme. Ndërsa kredia në Raiffeisen Bank është marrë si konsumatore dhe është përdorur për shpenzime familjare në vijimësi, pasi që prej muajit janar të vitit 2014 e në vijim, bashkëshortja ime është larguar nga puna, dhe në familjen time kishte vetëm një person të punësuar. Llogaria overdraft është hapur nga vetë banka në mënyrë automatike, pasi isha klient i saj, prej disa vitesh dhe rroga ime mujore kalonte në këtë bankë. Kemi vlerësuar që shuma e disponuar prej meje cash (e fituar në lojë fati), të ruhej e paprekur*

²⁷ Në nenin 4 përcaktohet se: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit”.

²⁸ Përgjigjet e pyetësorit nr. {***}.

nga ne, me qëllim kryerjen e ndonjë investimi të mëvonshëm, për të cilin në fakt nuk kemi gjetur ndonjë ofertë bindëse. Pavarësisht, se sikundër ju përmendni, nuk ka logjikë ekonomike në veprime të tilla, në vlerësimin tonë, janë çmuar asokohe, si të vlefshme për ekonominë tonë familjare. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson fillimisht se përdorimi i instrumenteve financiare (kredi, overdraft, etj.), për të përballuar shpenzime familjare në momente të caktuara mbetet një zgjedhje individuale, në varësi të mjeteve financiare të disponueshme dhe nevojave që ata kanë. Nën këtë logjikë, trupi gjykues e çmon si një vlerësim subjektiv qëndrimin e Komisionit se marrja e disa kredive konsumatore nga ana e subjektit të rivlerësimit në rrethanat e faktit mund të çojë drejt prezumimit se ai nuk e ka disponuar realisht shumën në fjalë.

29. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni, në analizën e tij mbi ecurinë e likuiditeteve cash, ndër vite, shtesave/pakësimeve, ka përllogaritur të gjitha shumat e deklaruarat prej tij në deklaratat periodike, duke deduktuar se gjendja e cash-it në monedhën lekë, në datën 31.12.2016 ka qenë në shumën 1.050.000 lekë dhe ka si burim pagat, ndërkohë që nga ana e tij nuk është kryer deklarim për gjendjen cash dhe, rrjedhimisht, as pakësimin e saj ndër vite ose burimin e tyre, as në DIPP-në e vitit 2016 dhe as në DIPP-të e mëparshme. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se në përgjigje të pyetësorit nr. {***} ai ka deklaruar gjendjen cash në fund të vitit 2016 në shumën prej 1.150.000 lekësh dhe 17.000 eurosh, duke marrë si referencë të gabuar gjendjen cash të përllogaritur nga Komisioni, e cila në fakt nuk është e saktë për shkak të mosdeklarimit të shtimit ose të pakësimit ndër vite. Sipas tij deklarimi në deklaratën e pasurisë vetting, në të cilën është deklaruar gjendje cash 9.000 euro me burim nga lojë fati online, është deklarimi i parë për gjendjen cash dhe deklarimi real, kjo pasi deri në fillim të muajit dhjetor të vitit 2016 gjendja cash në banesë ka qenë në shumën 75.000 euro me burim krijimi lojë fati, si dhe shumën prej 2.000 eurosh nga kursimet ndër vite. Nga kjo shumë i është dhënë babait hua vlere prej 58.000 eurosh në dhjetor, si dhe është paguar në janar 2017 në favor të DRT-së Vlorë vlere prej 1.250.000 lekësh, e konvertuar asokohe në 10.000 euro dhe diferenca e mbetur në banesë ishte (77.000 euro-58.000 euro-10.000 euro) 9.000 euro.

29.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues verifikoi fillimisht deklaratat e interesave private periodike të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, nga të cilat konstaton se:

- në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie të vitit 2003 deri në DIPP-në e vitit 2005 nuk janë kryer deklarime në lidhje me likuiditete në cash apo kursime;
- në DIPP-në e vitit 2006 deklarohet: *Gjendje në cash, viti 2006, 150.000 mijë lekë;*
- në DIPP-të për vitet 2007-2008 nuk janë kryer deklarime për likuiditete në cash shtesa/pakësime apo kursime;
- në DIPP-në e vitit 2009 deklarohet: *Kursime nga të ardhurat e pagës, 400.000 lekë;*
- në DIPP-në e vitit 2010 deklarohet: *Kursime nga paga 200.000 lekë;*
- në DIPP-në e vitit 2011 deklarohet: *Kursime nga paga 300.000 lekë;*
- në DIPP-të për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 nuk janë kryer deklarime në lidhje me shtim apo pakësim likuiditetesh cash; si dhe
- në DIPP-të për vitet 2015 dhe 2016 nuk deklarohen shtesa apo pakësime të gjendjes cash.

29.2 Gjatë hetimit administrativ, Komisioni e ka ftuar subjektin e rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me deklarimin e cash-it në deklaratat periodike ndër vite, që nga deklarimi i parë për vitin 2003, duke plotësuar gjendjen e tyre më 31 dhjetor të çdo viti. Në shpjegimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar²⁹ se: *Në lidhje me këtë moment dua të sqaroj se gjatë deklarimeve periodike në ILDKPKI kam pasqyruar vetëm ndryshimin e kursimeve për çdo vit, pra, shtimin në rastin tim, dhe jo gjendjen dhe ndryshimin e cash-it në fund të çdo viti kalendarik, duke menduar se kjo ishte e kuptueshme për shkak të deklarimit të kursimeve. Gjatë një pyetje si deklarues në ILDKPKI në muajin janar 2016, më është bërë me dije se duhej të deklaroheshin dhe ndryshimet e cash-it, kohë kur jam konsultuar me ligjin dhe kam konstatuar se për shkak pakujdesie nuk i kisha pasqyruar ndryshimet e cash-it në kohë. Në përgjigje të pyetjes Tuaj, shpjegimet e mia janë mbi gjendjen cash në mënyrë progresive, pra, gjendjen që unë disponoja në 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, përbri deklarimit të cash-it të evidentuar nga Komisioni, gjendjen cash në 31 dhjetor të çdo viti, sipas deklaratave private periodike, si vijon: (i) në deklaratën e vitit 2003 dhe në DIPP-në e vitit 2004 nuk ka deklaruar gjendje cash; (ii) në DIPP-në e vitit 2005 – deklarohet gjendja cash 150.000 lekë; (iii) në DIPP-në e vitit 2006 – deklarohet gjendja cash 150.000 lekë; (iv) në DIPP-në e vitit 2007 – 150.000 lekë; (v) në DIPP-në e vitit 2008 – 150.000 lekë; (vi) në DIPP-në e vitit 2009 – 950.000 lekë, me sqarimin se në deklarimin për këtë vit nuk janë deklaruar të ardhurat nga shitja e automjetit si shtim cash-i për shkak pakujdesie; (vii) në DIPP-në e vitit 2010 – 1.150.000 lekë; (viii) në DIPP-në e vitit 2011 – 1.450.000 lekë; (ix) në DIPP-në e vitit 2012 – 1.450.000 lekë; (x) në DIPP-në e vitit 2013 – 1.150.000 lekë; (xi) në DIPP-në e vitit 2014 – 1.150.000 lekë dhe 75.000 euro; (xii) në DIPP-në e vitit 2015 – 1.150.000 lekë dhe 75.000 euro; (xiii) në DIPP-në vitit 2016 – 1.150.000 lekë dhe 17.000 euro.*

29.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni e ka njohur subjektin e rivlerësimit me konkluzionin paraprak: *“Duket se ka mospërputhje të gjendjes së cash-it dhe burimit të tij të deklaruar në deklarimet periodike dhe në pyetësorë, me atë të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting pasi: - Nga deklarimet periodike, referuar shtesave dhe pakësime ndër vite të cash-it, nga përlllogaritjet rezultoi se gjendja e cash-it në monedhën “lekë” më 31.12.2016 është në shumën 1.050.000 lekë dhe ka si burim “pagat”; -- në deklaratën vetting (datë 29.01.2017) subjekti ka deklaruar cash 9.000 euro me burim nga “lojë fati online”; -- ndërsa në pyetësorin nr. {***} ka deklaruar gjendjen cash në shumën 1.150.000 lekë dhe 17.000 euro”.*

29.4 Gjithashtu, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës si vijon: *duket se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë lidhur me gjendjen e tij cash dhe burimin e tyre nga lojërat e fatit. Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarimin e bërë gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, duke shpjeguar se: [...] Në përgjigje të pyetësorit nr. {***}, kam deklaruar gjendjen cash në fund të vitit 2016 shumën prej 1.150.000 lekësh dhe 17.000 eurosh. Për këtë është marrë si referencë e gabuar prej meje gjendja cash e përlllogaritur nga Komisioni, e cila në fakt nuk është e saktë, për arsye të cilat i kam shpjeguar më sipër në lidhje me mosdeklarimin e shtimit ose pakësimit të cash në vite. Për këtë shkak, duke marrë në konsideratë dhe periudhën kohore që më është kërkuar deklarimi i gjendjes cash, për 1 periudhë nga 2003 deri 2016, pra, deri para 6 vitesh, vlerësimi ka qenë dokumentar, duke marrë të mirëqenë konstatimin e Komisionit dhe duke çuar në një përlllogaritje të gabuar prej meje, e reflektuar në dhënien e përgjigjes. Në lidhje me*

²⁹ Përgjigjet e pyetësorit nr. {***}.

gjendjen cash rezulton se gjendja ka qenë 19.000 euro në fund të vitit 2016, pra, në datën 31.12.2016. Pasi është paguar edhe tatimi për të ardhurat në mënyrën e shpjeguar më sipër, pagesë e kryer në muajin janar 2017, në kohën e deklarimit vetting kam pasur si gjendje cash në banesë shumën prej 9.000 eurosh me burimin e krijimit sikurse është deklaruar në deklaratën vetting.

30. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues, në kushte të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, lidhur me gjendjen *cash* të disponuar prej tij në fund të vitit 2016, analizoi ecurinë e likuiditeteve *cash*, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private periodike, duke i konsideruar kursimet e deklaruara në DIPP-të për vitet 2009, 2010 dhe 2011 si shtesa të likuiditetit në *cash*, sipas kërkesave të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, e të formularit të deklarimit të pasurisë të vitit respektiv. Nga kjo analizë, trupi gjykues konstaton se gjendja e *cash*-it në datën 31.12.2016 do të ishte në vlerën 1.050.000 lekë, sikurse përlllogaritur me të drejtë nga Komisioni, dhe jo aq sa është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* në shumën 9.000 euro apo sa është deklaruar prej tij gjatë hetimit administrativ në vlerën 1.150.000 lekë dhe 17.000 euro.
31. Në përmbledhje të sa më lartarsyetuar, në drejtim të saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me shumën prej 58.000 eurosh dhënë hua babait në dhjetor të vitit 2016 dhe likuiditete *cash* në vlerën 9.000 euro, deklaruar me burim të ardhura nga lojë fati *online* të realizuar në vitin 2014, trupi gjykues -- duke ritheksuar vlerën që kanë deklarimet e mëparshme të subjekteve të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave pasurorë, në vijim edhe të jurisprudencës të konsoliduar të Kolegjit, si dhe duke mbajtur në konsideratë: (i) mosdeklarimin në deklaratat e viteve 2014 e 2015 të disponimit në *cash* të të ardhurave nga lojërat e fatit pas tërheqjes së tyre nga Raiffeisen Bank ShA në vitin 2014; (ii) mosdepozitimimin në bankë të shumës së pretenduar të disponuar *cash* në banesë nga ana e subjektit të rivlerësimit pas kërkesës së ILDKPKI-së në janar të vitit 2016, për depozitimimin e saj, duke paraqitur pranë këtij institucioni mandatin përkatës; (iii) mosdeklarimin e huasë së dhënë babait në deklaratën e vitit 2016; (iv) pamjaftueshmërinë e gjendjes *cash* të rezultuar në fund të vitit 2016 në vlerën 1.050.000 lekë, për të mbuluar dhënien e huasë në vlerën 58.000 euro në fund të vitit 2016 dhe gjendjen *cash* në vlerën 9.000 euro; (v) përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në lojërat e fatit në mënyrë të vazhdueshme në periudhën 2012 – 2018 -- arrin në përfundimin se pavarësisht deklarimit të së ardhurës nga lojërat e fatit në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë disponimin e gjendjes *cash* të të ardhurave të përfituara nga lojërat e fatit, nga marsi i vitit 2014 deri në dhjetor të vitit 2016, të pretenduara si burim krijimi për huanë dhe gjendjen *cash*.
32. Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për dhënien e huasë së pretenduar babait në vlerën 58.000 euro dhe krijimin e likuiditetit *cash* në vlerën 9.000 euro të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me analizën financiare për periudhën 2003 – 2016

33. Komisioni ka arritur në konkluzionin se *subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të paguar shpenzimet dhe për të krijuar pasurinë në shumë totale prej 8.707.775 lekësh.*

34. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke pretenduar se *Komisioni edhe pse ka konkluduar se është provuar e ardhura e fituar në shumën 75.860 euro nga lojërat e fatit, e ardhura është përfituar nga subjekti dhe transfertat janë reale, e ardhura ka pasur burim të ligjshëm, si dhe për të janë paguar detyrimet tatimore, në mënyrë paradoksale nuk e ka konsideruar këtë të ardhur as në analizën financiare të vitit 2014 dhe as në vijim. Në kundërshtim me sa ka vepruar Komisioni, kjo e ardhur duhet të përfshihet në analizën financiare si e ardhur e ligjshme, për të cilën është deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë shuma dhe burimi i krijimit të saj.*
35. Në shqyrtim të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, referuar analizës financiare të Komisionit të pasqyruar në faqen 29 të vendimit, vëren se në të rezulton e përfshirë në zërin “të ardhura të dokumentuara” për vitin 2014 shuma prej 11.072.473 lekësh, e ardhur nga lojërat e fatit, si dhe në zërin “Shpenzime” shuma e shpenzuar prej 75.854 euro po në vitin 2014. Duke iu referuar arsytimit të bërë më sipër në vendim, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë disponueshmërinë e të ardhurave të përfituara nga lojërat e fatit nga viti 2014 deri në dhjetor të vitit 2016, trupi gjykues vlerëson se kjo shumë nuk mund të përfshihet në analizën financiare të Komisionit si burim për dhënien e huasë babait në shumën 58.000 euro në vitin 2016 dhe krijimin e gjendjes *cash* në shumën prej 9.000 euro. Bazuar në këtë arsyetim, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin se subjekti i rivlerësimit në ankim ka ngritur pretendime vetëm në lidhje me disponimin e të ardhurës së përfituar nga lojërat e fatit, duke qenë se kjo vlerë i ka shërbyer si burim krijimi për të kryer shpenzimet dhe krijuar pasurinë në vitin 2016, pa kontestuar asnjë zë tjetër të analizës financiare, trupi gjykues kontrollon analizën financiare për periudhën 2003-2016, nga e cila konfirmohet konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare për mbulimin e shpenzimeve dhe për të krijuar pasuritë në shumën totale prej 8.707.775 lekësh.
36. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues, në lidhje me analizën financiare për periudhën 2003-2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5 shkronja “b” e ligjit nr.84/2016.
37. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit në lidhje me kriterin e pasurisë, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

38. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni ka arritur në përfundimin se: *Referuar analizës së raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar, trupi gjykues vlerëson se në vështrimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje serioze e të përsëritura të natyrës procedurale, gabime thelbësore apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e veprimeve hetimore dhe vlerësimit të çështjeve nga subjekti i rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuara nga ligji nr. 84/2016. -- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, trupi gjykues çmon se referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe shkronjës “a”*

të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezultoi “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

39. Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka trajtuar në pjesën e vlerësimit të aftësive profesionale në drejtim të etikës dhe integritetit të prokurorit situatën që lidhet me angazhimin e subjektit të rivlerësimit në lojëra fati *online*. Pavarësisht kësaj, trupi gjykues vëren se kjo situatë nuk rezulton të ketë afektuar kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, por rezulton të jetë adresuar në vlerësimin tërësor të çështjes si sjellje që cenon besimin e publikut tek drejtësia, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
40. Në arritjen e konkluzionit të mësipërm, Komisioni ka arsyetuar³⁰ se: *Subjekti pretendon se veprimet e tij të pjesëmarrjes në lojëra fati nuk i ka ekspozuar në ambiente publike, por nga ana tjetër nëpërmjet deklarimit të këtyre veprimeve në deklaratat e të ardhurave dhe në deklaratën vetting pranë institucioneve që kanë akses nga publiku në lidhje me këto deklarata, e ka bërë të ekspozueshëm figurën e subjektit dhe këtë sjellje të tij përballë publikut. Edhe në rastet kur publiku i gjerë nuk ka mundësi të vërtetojë pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit në lojëra fati janë institucionet e rivlerësimit ato që kanë qasje në dokumente, të cilat vërtetojnë një zakon afatgjatë dhe të shpeshtë të pjesëmarrjes në lojërat e fatit bastet/online. Interesi i publikut për qëllime të verifikimit të këtyre sjelljeve përfaqësohet nga institucionet dhe është detyrimi i tyre për të vepruar në emër të interesit publik. [...] Sigurisht që është e kuptueshme gjendja psikologjike dhe emocionale që ka përjetuar subjekti, për shkak të situatave të rënda social ekonomike, por kjo nuk e justifikon varësinë e tij nga lojërat e fatit në mënyrë të vazhdueshme, çdo muaj, për vite me radhë që nga viti 2012 deri në gusht 2018, duke shpërfillur kështu edhe ligjin nr. 84/2016 dhe atë nr. 96/2016. [...] një prokuror që luan në mënyrë të vazhdueshme, shpenzon para duke qëndruar në faqet e lojërave të fatit dhe fiton para nga këto lojëra duhet të mbajë parasysh që ngre dyshime te publiku dhe cenon besimin tek ai si përfaqësues i drejtësisë, në lidhje me burimin dhe vlerën e parave që investon dhe që fiton në këto lojëra, si dhe me menaxhimin e kohës produktive të punës dhe detyrave të tij. [...] Subjekti i rivlerësimit ka luajtur në mënyrë të vazhdueshme për disa vite me radhë në lojëra fati, edhe pas miratimit të ligjit nr. 84/2016, duke investuar para në këto lojëra nga të cilat ka krijuar varësi se shumën e fituar në lojëra fati prej 75.854 eurosh, subjekti e ka tërhequr menjëherë nga llogaria bankare dhe nuk ka deklaruar as destinacionin e saj, as gjendjen cash të saj në asnjë DIPP, duke ngritur kështu dyshimin se këto para mund t'i ketë investuar në lojëra fati, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime që cenojnë etikën, integritetin, figurën e subjektit, si dhe shkallën e besueshmërisë së publikut te drejtësia.*
41. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se ky konkluzion është i pabazuar në ligj dhe se Komisioni, përveç mungesës së referencave ligjore, ka dështuar të arsyetojë se cilat janë kriteret e përdorura e të matshme për të pasur cenim besimi të publikut, cila është metodologjia e përdorur për përcaktimin e shkallës së varësisë nga lojërat e fatit, a përbëjnë lojërat e fatit një fenomen të ndaluar apo një fenomen shoqërisht të pranueshëm. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar disa argumente që paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si vijojnë: (i) kuadri ligjor i brendshëm³¹, përfshirë edhe Udhëzimet e Budapestit

³⁰ Në paragrafin 17, faqe 34 të vendimit.

³¹ Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, neni 10 i titulluar “Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale” parashikon se: “Prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës”; Ligji nr.

të cilave iu referohet Komisioni, kanë parashikuar në mënyrë të përgjithshme respektimin e rregullave të etikës, nderit dhe dinjitetit, të cilat diskreditojnë figurën e magjistratit ose dëmtojnë besimin e publikut te drejtësia, por nuk parashikojnë në mënyrë konkrete se cilat janë rregullat etike që duhen zbatuar ose sjelljet të cilat përbëjnë cenim të figurës së magjistratit; (ii) “Rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, të Prokurorit të Përgjithshëm, nuk përmbajnë asnjë parashikim në lidhje me veprimet e tij në drejtim të cenimit të integritetit, figurës dhe besueshmërisë së publikut tek drejtësia; (iii) veprimet e tij janë kryer në ambiente private të banesës, pa frekuentuar asnjëherë ambiente të lojërave të fatit e as ambiente të cilat do të cenonin integritetin e figurës së tij si prokuror, sipas nenit 10, pika 4³² të rregullave të etikës dhe sjelljes së prokurorëve, miratuar me urdhrin nr. 141, datë 19.06.2014, cituar më lart, sa kohë që nga informacionet e administruara nga agjencitë ligjzbatuese nuk ka rezultuar asnjë e dhënë në drejtim të përfshirjes së tij në veprimtari ose sjellje që do të cenonin figurën e magjistratit; (iv) Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 17, pika 2³³ të rregullave të etikës së prokurorëve, sa kohë që nga ana e organeve të ngarkuara nuk ka pasur konstatime për shkelje disiplinore të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si dhe duke përcaktuar si shkelje etike, një sjellje që nuk është përcaktuar si e tillë në këtë akt; (v) argumentimi i Komisionit se interesi i publikut përfaqësohet nga institucionet nënkupton që në krye të herës se këto institucione duhet të udhëhiqen nga parimi i ligjshmërisë; (vi) konsiderimi i veprimeve të tij si veprime që cenojnë integritetin, figurën, si dhe shkallën e besueshmërisë së publikut te drejtësia përbën shkelje të parimit “*nulla poena sinne legge*”, të sanksionuar në nenin 7 të KEDNj-së dhe në nenin 29 të Kushtetutës; (vii) veprimet e tij asokohe janë kondicionuar nga përjetimi moral, pas një aksidenti më pasojë vdekje, në të cilin ai është përfshirë në vitin 2013, si dhe situatës familjare pas largimit të padrejtë nga puna të bashkëshortes së tij në vitin 2014; (viii) pavarësisht se veprimet e tij janë kryer në ambiente private, banesë, dhe kurrë në ambiente publike, pra, kanë pasur impakt publik mbi figurën e tij, ato janë veprime që nuk duhet të kryheshin prej tij. Në mbështetje të këtyre argumenteve, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje edhe vendimin e Kolegjit (JR) nr. 25, datë 14.10.2019³⁴.

42. Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka renditur disa fakte që, sipas tij, dëshmojnë mbi punën e tij në drejtim të shkallës së besueshmërisë së kolegëve të tij dhe të publikut te drejtësia, konkretisht: (i) më datë 09.05.2018 ai është caktuar Drejtues i Seksionit të veprave penale të

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”, i ndryshuar, i cili në nenin 101/1, germa “a” parashikon se: “Magjistrati kryen shkelje disiplinore, me dashje ose për shkak të pakujdesisë, kur: a) kryen veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërmbyllje të detyrës, sjellje jo profesionale ose jo etike gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e magjistratit, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë [...]”; Ligji nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në nenin 32 parashikonte si shkelje disiplinore: “d) kryerja e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit”.

³² Në nenin 10, pika 4 përcaktohet se: “Prokurorët nuk duhet të frekuentojnë ambiente ose lokale të cilat dëmtojnë imazhin e tyre si prokuror”.

³³ Në nenin 17, pika 2 përcaktohet se: “Veprime që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit përbëjnë shkeljet e rregullave të përcaktuara në pikat [...], si dhe akte e sjellje të tjera në shkelje të rregullave, që rast pas rastit vlerësohen se kanë diskredituar rëndë pozitën dhe figurën e prokurorit”.

³⁴ Në këtë vendim, në faqen 20 arsyetohet se: “Trupi gjykues i Kolegjit konstaton, gjithashtu, se nga Prokuroria e Përgjithshme nuk ka pasur asnjë procedim disiplinor, edhe në kuptim të shkeljes së rregullave të etikës, në emër të subjektit të rivlerësimit përgjatë gjithë karrierës së tij, edhe pse ai ka deklaruar në deklaratat periodike të pasurisë të cilat janë të hapura për publikun, që në vitet 2006-2008, ka marrë pjesë në lotari sportive. Gjithashtu, gjatë procesit të rivlerësimit nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të kishte vazhduar përfshirjen e tij në lotari sportive për një periudhë të paktën 10-vjeçare, trupi gjykues i Kolegjit e gjen jo të drejtë konkluzionin e Komisionit, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit duke marrë pjesë në lojërat e fatit, në vitet 2006-2008, ka cenuar figurën dhe integritetin e tij, duke ulur shkallën e besueshmërisë të publiku”.

tjera në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; (ii) më datë 27.07.2020 është caktuar Drejtues i Seksionit të Posaçëm kundër Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit, Krimeve Financiare, si dhe Hetimeve Pasurore në Prokurorinë, pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; (iii) më datë 09.02.2021 është caktuar zv/drejtues i Prokurorisë së Vlorës i votuar nga kolegët e tij të punës, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 4 e ligjit nr. 97/2016; (iv) në vitet 2021 – 2022 ka ushtruar ndjekjen penale për disa procedime penale që kanë pasur impakt publik, konkretisht procedimi penal nr. {***}, nr. {***} dhe nr. {***}, sipas njoftimeve në faqen zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme.

43. Nga verifikimi i akteve të administruara në fashikullin e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton faktet dhe rrethanat, si më poshtë:

43.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2014 se ka përfituar të ardhura në vlerën 79.027,50 euro të përfituara prej tij nga angazhimi në lojëra fati *online* në vitin 2014. Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në datat 11.01.2016 dhe 20.01.2016, lidhur me shumën e përfituar në vitin 2014 nga lojërat e fatit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *“Të ardhurat janë përfituar online nga një lojë fati, në website-n {***}.com. Në këtë faqe unë kam hapur një llogari personale në të cilën depozitoja në periudhë të ndryshme kohore, prej kartës sime të kreditit, shuma që varionin 100-200 euro. [...] Këto shifra shërbenin për baste sportive online. Në dijeninë time kjo është një kompani ndërkombëtare e licencuar për të zhvilluar këtë aktivitet. Në rastin konkret, unë kam depozituar një shumë të tillë 2-3 ditë përpara se të fitoja shumën, shumë e cila ka kaluar direkt në kartën e kreditit. [...] Gjithashtu, po ju paraqes dy gjendjet e llogarive pranë Raiffeisen Bank të muajve dhjetor 2013 si dhe janar -shkurt 2014, ku pasqyrohet transferimi i shumave prej kartës sime të kreditit në favor të kompanisë së basteve Bet365 [...]”*.

43.2 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“[...] Më datë 19.03.2014 janë kryer prej meje disa pagesa me kartë krediti dega Raiffeisen Bank, Vlorë, 4 pagesa në total gjithsej 850 euro. Në llogarinë që disponoja në faqen online www.{***}.com. Më datë 09.08.2018 janë kryer prej meje disa pagesa me kartë krediti në Raiffeisen Bank, Dega Vlorë, 3 pagesa në total prej 550 eurosh. Në llogarinë që disponoja në faqen online www.{***}.com”*. Ndërkaq, nga verifikimi i të dhënave të llogarisë në valutë Master Card, me nr. {***}, në Raiffeisen Bank ShA, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesa në favor të subjektit “{***}”, në vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018.

43.3 Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës: *“Subjekti i rivlerësimit ka rezultuar se ka pasur lëvizje bankare në vijueshmëri për periudhën 2012-2016 të vlerave monetare, me destinacion lojërat e fatit, të cilat nuk vijnë në përputhje me figurën dhe integritetin e një prokurori e, po ashtu, ulin shkallën e besueshmërisë së publikut te drejtësia”*. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë rezultat hetimi me të njëjtat argumente si ato të parashtruara në ankim, duke mbajtur qëndrimin se veprimet e kryera prej tij në ambiente tërësisht private nuk përbëjnë shkelje të asnjë prej rregullave të etikës të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Megjithatë, tej këtyre argumenteve, ai është shprehur se ndihet i keqardhur nga kjo situatë, pasi nuk do të donte që të ishte ky *fotografimi* që i bëhej figurës së tij si prokuror, dhe pavarësisht se veprimet e tij janë kryer në ambiente private, sa kohë që kanë pasur impakt publik, janë veprime që nuk duhet të kryheshin prej tij.

44. Në analizë të situatës së fakteve të parashtruara më lart, trupit gjykues i rezulton se subjekti i rivlerësimit është angazhuar në lojëra fati *online*, në një periudhë kohore disavjeçare 2012-2018, në mënyrë të vazhdueshme, pranë kompanisë së huaj “{***}”, që operon në fushën e lojërave të fatit *online*, periudhë gjatë së cilës ai ka qenë në ushtrim të funksionit të prokurorit. Angazhimi i tij është kryer përmes pagesave të kryera në favor të kësaj kompanie nga llogaria e tij e kartës së kreditit në Raiffeisen Bank ShA, angazhim nga i cili në vitin 2014 ka përfituar një shumë të konsiderueshme të ardhurash në vlerën 79.027,50 euro. Referuar legjislacionit të posaçëm që rregullon sjelljen e prokurorëve, trupi gjykues vëren se sjelljet e prokurorëve që kanë potencial të cenojnë figurën e tyre janë sanksionuar gjithmonë e më shumë në drejtim të konkretizimit të tyre. Në kohën që subjekti i rivlerësimit është angazhuar në lojëra fati, rregullat e sjelljes së prokurorëve ishin përcaktuar fillimisht (për periudhën 2012-2016) nga ligji nr. 8737/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet respektive. Ky ligj në nenin 32 të tij, parashikonte si një ndër shkeljet e rënda disiplinore edhe [...] d) kryerja e veprimeve që diskreditojnë rëndë figurën e prokurorit. Këto rregulla janë parashikuar edhe në akte nënligjore, siç është urdhri nr. 141, datë 19.06.2014 “Për miratimin e rregullave mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve”³⁵, të cilat në nenin 3, pika “ë” parashikonin se prokurorët, në çdo kohë dhe në të gjitha rrethanat, duhet: *Të jenë dhe të tregohen objektivë, të pavarur, të paanshëm, të shmangin çdo papajtueshmëri me funksionin, të ndërgjegjshëm për detyrimet etike e profesionale dhe të veprojnë në atë mënyrë që të nxisin besimin e publikut në dinjitetin, integritetin dhe ndershmërinë e tyre*. Pas vitit 2016, këto sjellje u rregulluan nga ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili, si shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit, në nenin 103 ka përcaktuar: dh) *raste të tjera të sjelljes që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit dhe dëmton besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, të kryera jashtë ushtrimit të detyrës*.
45. Veç legjislacionit të brendshëm, rregullat mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve kanë gjetur rregullim edhe në disa akte ndërkombëtare. Në Udhëzimet e Budapestit, mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës në datën 31 maj 2005³⁶ përcaktohet se: *“Prokurorët duhet të sillen në mënyrë të atillë që të forcojnë dhe të ruajnë besimin e publikut në profesionin e tyre”*. Angazhimi i magjistratëve në lojërat e fatit ka gjetur trajtim edhe më specifik në Kommentarin e Bangalores³⁷ për sjelljen e gjyqtarëve, që zbatohet *mutatis mutandis* edhe për prokurorët, sipas së cilit, ndonëse nuk ka asnjë ndalim që një gjyqtar të angazhohet në lojërat e fatit të rastit si një aktivitet i kohës së lirë, theksohet se duhet mbajtur parasysh perceptimi i një vëzhguesi të arsyeshëm. Gjyqtari, sipas këtyre komenteve, duhet të pranojë disa kufizime edhe në aktivitetet që të kryera nga qytetarët e zakonshëm nuk do të kishin një impakt negativ. Në këtë komentari vihet, gjithashtu, në dukje ndryshimi mes një vizite të rastësishme në garat e kuajve ose në një kazino jashtë vendit gjatë një pushimi dhe qëndrimit të shpeshtë në pistat e garës nga një lojtar i rregullt.

³⁵ Shih linkun: https://www.pp.gov.al/rc/doc/rregullat_e_etikes_dhe_sjelljen_e_prokuroreve_820_5019.pdf

³⁶ Udhëzimet e Budapestit mbi etikën dhe sjelljen e prokurorëve publikë, miratuar nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm në datën 31 maj 2005, pjesa IV “Sjellja private”: <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>

³⁷ Shih komentarin nr. 114 dhe nr. 117, të Komentarit të Bangalores në linkun: https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf

46. Në vijim të sa më lart, nisur nga formimi profesional, por edhe nga përvoja e subjektit të rivlerësimit në detyra të rëndësishme në organin e prokurorisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit duhet të kishte vetëanalizuar edhe sjelljen e tij jashtë detyrës dhe impaktin që një veprimtari e tillë e kryer për një kohë të gjatë mund të kishte në publik. Në vendimin (JR) nr. 25, datë 14.10.2019, të referuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vëren se pjesëmarrja në lotari sportive e tij, në atë rast, kishte vijuar vetëm për tre vite 2006-2008, në një kohë relativisht të largët nga deklaratat e pasurisë *vetting*, ndërkohë në rastin konkret përfshirja e subjektit të rivlerësimit ka zgjatur në kohë, duke u kryer në mënyrë të rregullt për rreth 6 vite, edhe pas dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, duke mos i krijuar trupit gjykues bindjen se ai ishte shkëputur dhe distancuar nga një aktivitet i tillë. Në këto rrethana, edhe qëndrimi i mbajtur nga subjekti i rivlerësimit, i fokusuar fillimisht në faktin se veprimet e kryera prej tij në ambiente tërësisht private nuk përbëjnë shkelje të ndonjë rregulli të etikës apo nuk parashikohen si të tilla nga legjislacioni në fuqi e, më pas, këto veprime nuk duhet të ishin kryer prej tij sa kohë që kanë pasur impakt publik, në vlerësimin e trupit gjykues, u çmuan si përpjekje për të përqasur situatën në favorin e tij. Pjesëmarrja e subjektit të rivlerësimit në lojëra fati *online* për një periudhë shumëvjeçare nuk e justifikon as argumenti tjetër se përfshirja e tij në këtë situatë është kondicionuar edhe nga disa rrethana familjare të tilla si përfshirja në një aksident në vitin 2013 apo largimi nga puna i bashkëshortes në vitin 2014, sa kohë që kjo situatë ka vijuar përpara dhe pas këtyre ngjarjeve.
47. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se angazhimi i subjektit të rivlerësimit në lojëra fati, qoftë edhe *online*, për një periudhë kohore disavjeçare 2012-2018³⁸, përbën një sjellje jashtë kryerjes së detyrës, në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes së një magjistrati, që nuk i përgjigjet qëllimit të procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit që subjekti i rivlerësimit nëpërmjet angazhimit në lojërat e fatit *online* ka cenuar besueshmërinë e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
48. Nga analizimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se ai ka kundërshtuar konkluzionet e Komisionit, në lidhje me dy procedime penale të marra në shqyrtim nga Komisioni, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, konkretisht: (i) procedimin penal nr. {***}³⁹ të trajtuar në kuadër të të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme; si dhe (ii) procedimin penal nr. {***}, aktet e të cilit janë veçuar nga procedimi penal nr. {***}⁴⁰, të adresuar nga denoncimet e publikut. Referuar përmbajtjes së vendimit, trupi gjykues vëren se problematikat e konstatuara nga Komisioni, në lidhje me këto dy procedime penale, nuk kanë afektuar konkluzionin mbi aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit⁴¹ dhe nuk janë adresuar nga Komisioni, as si problematika në drejtim të cenimit të besimit të publikut. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pavend analizimin e shkaqeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këto dy procedime penale dhe pa ndonjë efekt në vendimmarrjen e tij.

³⁸ Në këtë periudhë, subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

³⁹ Paragrafët 6.1- 6.8, të vendimit të Komisionit.

⁴⁰ Paragrafët 6.14 - 6.32, të vendimit të Komisionit.

⁴¹ Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

49. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Bazuar në sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 555 , datë 22.07.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i drejtë dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 555, datë 22.07.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Alfred Sali.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 07.05.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi